

STATUT I SHOQERISE
“Novastudio” Sh.P.K

Ky Statut do te konsiderohet se inkorporon dherose perfshin Aktin e Themelimit te Shoqerise, organizimi dhe funksionimi i te ciles rregullohet ketu.

Sot, me 1 Nentor 2022, personat e meposhtem:

Z. Gazmir Isaj, shtetas shqiptar, lindur me 02.10.1972 ne Durres (ALB) e banues ne Shqiperi, mbajtes i leternjoftimit me nr. personal H21002047N, madhor e me zotesi te plete juridike e per te vepruar,
dhe

Z. Orges Isaj, shtetas shqiptar, lindur me 10.02.1982, ne Durres (ALB) e banues ne Shqiperi, mbajtes i leternjoftimit me nr. personal I20210087R , madhor e me zotesi te plete juridike e per te vepruar,

ne perputhje me Ligjin Nr.9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, te ndryshuar
dhe me legjislacionin e zbatueshem ne Republiken e Shqiperise, miratuan kete Statut si vijon:

Ne kete statut:

- “Ligji” eshte Ligji 9901/2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare”, i ndryshuar;
- “Statuti” eshte ky Statut i Shoqerise;

Kreu I
Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

Neni 1
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, me 1/11/2022, ne, themeluesit e mesiperm, kemi krijuar nje shoqeri me perqegjesi te kufizuar
me emrin dhe emertimin tregtar **“Novastudio” SH.P.K.**

Neni 2
Objekti

Shoqeria ka për objekt veprimtarinë e mëposhtme:

- a) Kontraktimi i agjenteve te shitjes me ose pa depozite, tregtimi, shpërndarja dhe asistenca e lidhur me te, si per vete edhe per llogari te te treteve, importimi dhe eksporti i produkteve të veshjeve, per burra dhe gra si dhe aksesoreve te lidhur me to;
- b) Konsulence ne fushen e stilimit, projektimit dhe realizimit ne sektoret e veshjeve dhe aksesorëve të lidhur, specifikisht: këpucë, çadra, çanta, rripa, syze, si edhe bizhuteritë, argjendaria, parfumeria dhe linjat kozmetike;
- c) Konsulencë per te tretet, ne lidhje me njohjet e tregut, shperndarjen dhe njohurite (Know-how) ne perjithesi në sektorët e veshjeve dhe aksesorëve te lidhur me to;
- d) Mbledhja e te dhenave (scouting) në lidhje me njohjen e tregut për gjetjen e personelit, kerkimin e vendit te punes, ekspozitoreve ne showroom-e, xhirimeve dhe ngjarjeve ekspozuese;
- e) Ideimi, projektimi, realizimi dhe tregtimi I objekteve dhe aksesoreve te arredimit;
- f) Ideimi, projektimi dhe realizimi I hapësirave ekspozuese, stendave, vitrinave dhe dyqaneve;

Gazmir Isaj

Orges Isaj
Fotointigzi

- g) Prodhami, përpunimi, paketimi, tregtimi, shitja, shpërndarja, dergesa si dhe transporti, per veten dhe/ose per te trete, drejtpërdrejt dhe/ose indirekt, me shumicë dhe pakicë, ne telefon ose korrespondece telematike perfshire rrjetin internet dhe cdo lidhje virtuale, kibernetike, si me mjete dhe/ose shërbime postare edhe me mjete transporti në përgjithësi, të produkteve të veshjeve për burra dhe gra dhe aksesorëve të lidhur, si p.sh.: këpucë, çadra, çanta, rripa, syze, si dhe bizhuteri, argjendari, parfumeri dhe linja kozmetike., si edhe objekte e aksesore te arredimit;
- h) Organizimi I panaireve dhe organizimeve te tjera ekspozuese ne lidhje me veshjet dhe aksesoret relative, si kepuce, cadra, canta, rripa, size, si edhe bizhureteri, argjendari, parfumeri dhe linje kozmetike. Organizimi I eveneteve online dhe offline perfshire evenete skenike, qiramarrje te strukturave, arredim, pajisje dhe projektimi I pajisjeve;
- i) Sherbime te komunikimit dhe zyrave te shtypit perfshire shtypin digjital dhe shumekanalesh perfshire prodhimin e permajtjeve sociale, editoruale si edhe video, per komunikim online dhe offline, Marketing digjital, Marketing strategjik, Analize projektesh/menaxhim/zhvillim, prodhime e përmajtje digitale, aktiviteteteteve te mediave sociale , planifikim digital, partneritet mediatik me perdorues TikTok-u, influencuesit;
- j) Krijimi dhe ndërtimi i faqeve të internetit duke përfshirë publikimin e tyre në internet. Krijimi dhe ndërtimi i e-commerce si ne versionin B2B edhe B2C;
- k) Mbledhja e te dhenave te bleresve, asistence per bleresit, scouting tradutrici, fotografi, MUA, vendndodhje, mode;
- l) Mode, stilim, marka, tregtim, konsulencë tregtare me shumice/me pakice/me shume kanale tregtimi, si me shumice edhe me pakice;
- m) Gjithashu mund të kryejë, si aktivitet shtese dhe jo primar, çdo operacion industrial, tregtar, me pasuri te luajtshëm, të paluajtshme dhe financiarë, duke përfshirë lëshimin e garancive dhe letrave te garancise, e vendosur nga organi administrative si te nevojshem dhe te dobishem per vazhdimin e objektit te aktivitetit, të marrë persiper drejtpërdrejt dhe terthorazi interesa dhe aksione në shoqëri dhe ndërmarrje të tjera që kanë një objekt analog, të ngashëm ose të lidhur me të shoqerise, të lëshojë garanci dhe leter garancie edhe në interes të të tretëve;
- n) Ndermjetesimi finanziar.

**Neni 3
Kohezgjatja**

Kohezgjatja e shoqerise do te jete *e kufizuar deri me 31.12.2050.*

**Neni 4
Selia**

Selia e shoqerise ndodhet ne adresen: Kullat Binjake, Kulla 2, Bulevardi Deshmoret e Kombetit, P.O. Box 8196, 1019, Tirane .

Me vendim te Administratorit, Shoqeria mund te hape dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashte Republikes se Shqiperise.

**Kreu II
Kapitali**

**Neni 5
Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar fillestari i shoqerise eshte 1,000 Euro, kundervlera ne Lek **117,000 LEKE (njeqind e shtatembedhjete mijë leke)** dhe zoterohet teresisht nga ortaket themelues si vijon:

Gazmira Loma

Foto 2ngj.7

- **Z. Gazmir Isaj** : Zoterues i 1 (nje) kuote me vlerë te per gjithshme 111,150 Leke (njeqind e njem bedhjetë mijë e njeqind e pesedhjetë leke) që perben 95 % te kapitalit themeltar te shoqerise, dhe
- **Z. Orges Isaj** : Zoterues i 1 (nje) kuote me vlerë te per gjithshme 5,850 Leke (pesemijë e teteqind e pesedhjetë), që perben 5 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kontributi i ortakeve eshte ne para.

Secili ortak do te kete nje numer proporcional votash me vleren nominale te kuotes se tij.

Neni 6 Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjesave te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet, zvogelimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjesave te kapitalit qe perfaqesojne.

Neni 7 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet: kontributit ne kapitalin e shoqerise, shitblerjes, trashegimise, dhurimit, ose çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj. Çdo disponim ne favor te nje pale te trete nepermjet veprimeve juridike ndermjet te gjalleve duhet te behet ne forme notieriale dhe te regjistrohet. Ne rastet e transferimit te pjesave te kapitalit me kundersherblim, ortaket e tjere kane te drejten e parablerjes.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut. Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8 Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e per gjithshme e ortakeve eshte per gjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per çeshtjet e me poshtme:

- percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- ndryshimet e statutit;
- emerimin e shkarkimin e administratoreve;

Gazmire Isaj

Dafina Rama
Faksimile

- d) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- e) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "d" te ketij neni;
- f) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- h) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- i) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- l) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- m) shperndarjen e fitimeve vjetore;
- n) çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e per gjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veprojne si perfaquesues i ortakeve ne asamblene e per gjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se per gjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

Neni 9

Menyra e Thirrjes se Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e per gjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vandin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e per gjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

Neni 10

Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e per gjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 per qind te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e per gjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 11
Marrja e vendimeve

Asambleja e Pergjithshme vndos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme vndos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per çeshtje te tjera si: percaktimi i politikave tregtare te shoqerise; emerimin e administratoreve; emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar; percaktimin e shperblimeve; mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise; perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve; miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese.

Neni 12
Perjashtimi nga e drejta e votes

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese Asambleja e Pergjithshme merr vendim per: vleresimin e veprimtarise se tij; shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij; ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria; dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaquesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

Neni 13
Administrimi

Asambleja e Pergjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit eshte 5 vjet me te drejte riperteriteje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Personi i meposhtem caktohet si Administrator i pare i shoqerise per nje mandat 5 (pese) vjeçar emerimi: **Z. Gazmir Isaj**, shtetas shqiptar, lindur me 02.10.1972 ne Durres (ALB) e banues ne Shqiperi, mbajtes i leternjoftimit me nr. personal H21002047N , madhor e me zotesi te plote juridike e per te vepruar.

Administratori do te:

- (i) administroje veprimtarine tregtare te Shoqerise duke zbatuar politikat tregtare te miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve;
- (ii) perfaqesoje Shoqerine;
- (iii) kujdeset per mbajtjen e rregullt te librave dhe dokumenteve kontabel;
- (iv) perqatise dhe nenshruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise, te cilat ia paraqet Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve per miratim, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve;
- (v) krijoje nje sistem njoftimi te pershtatshem per rrethanat qe kercenojne ekzistencen e Shoqerise;
- (vi) kryeje regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te Shoqerise, sipas kerkesave te Ligjit Tregtar apo te ligjeve te tjera te zbatueshme;
- (vii) raportoje perpara Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve mbi zbatimin e politikave tregtare si dhe per perfundimin e transaksioneve me rendesi te veçante per performancen e Shoqerise;
- (viii) kryeje detyra te tjera, te percaktuara ne Ligjin Tregtar dhe ne kete Statut;

Gazmir Isaj

Foto: Shqipëri

(ix) therrase mbledhjen e Asamblese se Ortakeve sa here qe kerkohet sipas Ligjit apo ketij Statuti.

Administratori mund te autorizoje persona te tjere per te vepruar ne emer dhe per llogari te tij, duke specifikuar/percaktuar katergorine e akteve dhe veprimeve qe perfajesuesi mund te kryeje.

Kreu IV

Viti finanziar. Llogaritje vjetore, fitimet dhe rezervat ligjore

Neni 14

Viti Financiar

Viti finanziar ka nje kohezgjatje prej 12 (dymbedhjete) muajsh e cila fillon 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

Neni 15

Ekspertet

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te emeroje nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar per kontrollin e llogarive te Shoqerise.

Neni 16

Rezerva Ligjore

Shoqeria do te kaloje ne fondin rezevre te detyrueshem te pakten 5% (pese perqind) te fitimit vjetor neto derisa kjo rezevre te arrije vleren e barabarte me 10 per qind te kapitalit themeltar.

Neni 17

Dividentet

Pas miratimit te bilancit vjetor dhe rezultatit finanziar, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve percakton shumen e fitimeve qe do t'i shperndahet secilit prej Ortakeve si divident, ne perpjestim me pjesen perkatese ne kapitalin themeltar.

Kreu V

Prishja – Riorganizimi i Shoqerise

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e Shoqerise mund te behet ne çdo kohe: (i) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj; ose (ii) me vendim te Asamblese se Ortakeve; ose (iii) me hapjen e procedurave te falimentimit; ose (iv) ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit 9723/2007; ose (v) me vendim te gjykates.

Fouad Begaj

Ne kete rast, Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar l apo disa likuidatore dhe shenuar ne çdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoperi ne likuidim e siper".

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur një procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit qe jane emeruar nga Ortaket.

Nese Ortaket nuk marrin një vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar një likuidues.

Neni 19
Riorganizimi i shoqerise bashkimi-ndarja

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2012 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Neni 20
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete Statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.


Neni 21
Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente gjykata e rrethit gjyqesor ne territorin e te ciles ka seline Shoqeria.

Ky Statut neshkruhet rregullisht ne gjuhen Shqipe.

**ORTAKET THEMELUES
TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"Novastudio" Sh.P.K.**

Z. Gazmir Isaj



Z. Orges Isaj



Faqez Isaj